



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve
Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Lënda : *Minutat e takimit për draft vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të ndikimit në mjedis”*

Ditën e hënë datë, 06.07.2015, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për draft vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”

Në këtë takim merrnin pjesë këta përfaqësues:

Z. Arben Lici, ECA Studio Konsulent;

Znj.Emirjeta Adhami, përfaqësuese e Shoqatës INCA

Z.Erlind Muha, përfaqësues i shoqërisë civile.

Nga Ministria e Mjedisit ishin këta përfaqësues:

Z. Redi Baduni, Drejtor i Mjedisit

Znj. Madalena Koja, Përgjegjëse e Sektorit të Legjislacionit

Znj. Ornela Shoshi, përgjegjëse e Sektorit të VSM-së, VNM-së Standarteve Mjedisore dhe të Aksidenteve Industriale

Znj. Borana Andoni, specialiste e Sektorit të VSM-së, VNM-së Standarteve Mjedisore dhe të Aksidenteve Industriale

Znj. Edlira Dersha, specialiste, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Znj. Ilda Shahu specialiste e Sektorit të VSM-së, VNM-së Standarteve Mjedisore dhe të Aksidenteve Industriale

Znj. Sabina Cenameri, specialiste e Sektorit të VSM-së, VNM-së Standarteve Mjedisore dhe të Aksidenteve Industriale

Nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit ishin pjesmarrës:

Znj. Evis Melonashi, Shefe e sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Znj. Etleva Sinoimeri specialiste e sektorit të Vlerësimit në Mjedis

Dëgjesa u hap nga z. Redi Baduni, i cili shprehu rëndësinë e kësaj dëgjese për të ndihmuar procesin e hartimit të legjislacionit mjedisor e në veçanti të këtij

draft Vendimi të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të ndikimit në mjedis" Z. Baduni shpjegoi se arsyeja e hartimit të kësaj Vendimi të Këshillit të Ministrave është për të përmbushur rekomandimet e Bashkimit Europian në lidhje me procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Gjithashtu ai shpjegoi të pranishmëve se tashmë Ministria e Mjedisit, do të jetë porta hyrëse e kërkesës së biznesit për të paraqitur kërkesën për aktivitete që mund të kenë ndikim në mjedis, duke shmangur Qendrën Kombëtare të Liçensimit.

Më pas z. Baduni ja dha fjalën znj. Ornela Shoshi, e cila bëri një prezantim të këtij draft vendimi.

Znj. Shoshi pasi bëri një prezanti të rëndësisë së hartimit të këtij projektakti, qëllimi i të cilit është krijimi i një procedure, përsa i përket rregullave, përgjegjësive, afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM-së) pa përfshirjen e QKL-së.

Ky projekt vendim synon të përcaktojë rregullat dhe kriteret:

- për ngritjen e një sistemi kombëtar, bashkëkohor dhe të integruar të vlerësimit të ndikimit në mjedisi për të arritur në një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes; parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis;
- përcaktimin në mënyrë të qartë dhe të plotë të procedurës se vlerësimit që ndiqet nga personat fizikë e juridikë në rolin e zhvilluesit të projektit dhe nga administrata dhe institucionet qendrore e vendore në rolin e organeve vendimarrëse;
- rritjen e bashkëpunimit institucional (qendror dhe vendor) për mbrojtjen e mjedisit duke i ngarkuar përgjegjës të në procedurë sipas funksioneve dhe duke lehtësuar zbatimin e legjislacionit të planifikimit të territorit dhe mbrojtjen e mjedisit;
- lehtësimin dhe rritjen e sigurisë për investimet në vend duke u dhënë mundësinë institucioneve përgjegjëse që të shprehen që në fazat më të hershme për projektin e propozuar;

Më pas znj. Shoshi prezantoi më në detaj 4 kriteret e këtij vendimi.

Përfaqësueset e Agjensisë kërkuan që të reflektohej në lidhje me detajimin për vendodhjen e aktivitetit si dhe afatet kohorë që Ju liheshin kësaj agjensie për shqyrtimin e kërkesës.

Z. Arben Liçi kishte komente në pikën 6 të kreut 2 në lidhje me Analizën që duhej bërë dy alternativave të shihej mundësia e ndyshimit të kësaj kërkesë në lidhje me situatën reale në vend.

Takimi u mbyll duke u kërkuar nga përfaqësuesit e organizatave që do të dërgonin komentet e tyre brënda 24 orëve në vazhdim.